M E H M E T R R E M A

VALIXHET E SHPRESAVE

POEZI

Ja detikoj të shtrenjtës Nënës time!

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Titulli i librit:
Valixhet e shpresave

Poezi

Autor:

Mehmet Rrema

Redaktor:

Xhevahir Cirongu

Korrektor:

Engjëllushe Rrema

Kopertina:

Pikturë nga Bashkim Alushi

Shtëpia botuese :

Tiranë-Barleti,2018

Korrik, 2018

ISBN 978-9928-238-74-0

Falënderim: Nuk besoj se botimi i këtyre poezive do të kishte qenë i mundur pa ndihmën e gjithëanshme të paçmuar dhe të pa kursyer të poetit dhe mikut tim të vyer ADEM ZAPLLUZHA Faleminderit mik!

Mehmet Rrema

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Parathënie

Me poetin Mehmet Rrema jam ‘’takuar‘’me vargjet e tija poetike nëpërmjet rrjeteve sociale, por edhe në shtypin e shkruar. Duke lexuar vargjet e poezive të cilat i ngjajnë luleve të malit, ato na përcjellin atë aromë poleni dhe freskinë e mesazheve deri në skutat e shpirtit tonë si lexues e dashamirës të poezisë. Vetë poeti është varg i shkruar, në radhë të parë brenda qenies së tij, pastaj ashtu si një lum që merr me vete gjithçka që nuk kursen as gurë, ashtu edhe poeti Mehmet Rrema vjen e derdh ‘’Lumin’’ shpirtëror bashkë me kristalet e fjalës poetike në vëllimin e titulluar ‘Valixhet e shpresave’’. Ky vëllim përfshin në gjithë brendinë e tij 72 poezi.Larmija e tematikave është e shumëllojshme. Ajo ka kolori tema duke filluar që nga shpresat e gëzimeve, dashurinë, dhimbjen e tragjiken, personazheve të përveçëm njerëzor, botës së lirë që na rrethon, e mbi të gjitha poeti Lutet në ZOT!

Universi i poezive të poetit Mehmet Rrema, na bën që të fluturojmë bashkë me ëndrrat tona drejtë hapsirës së qiellit blu, sepse lirizmi e metaforat e shprehura prej tij në vargjet e poezive, kanë forcën e shpresave dritëdhënse, të cilat i shqyejnë rrugët e valixheve të kohës shtrigë që ne jetojmë. Ky mesash duket qartë, lexuesi e gjen qysh në fillim të titullit të këtij libri poetik. E si rrjedhojë i kësaj ai gjen farën shpirtërore duke i thënë jetës: Të Dua! Poetët vijnë rreth botës që na rrethon si gurë meteorikë, të cilët shpalosin fjalën e skalitur plot ndjenjë e dashuri në vëllimet poetike, për ti dhënë liri e shpresë shoqërisë njerëzore. Fjala të jep dritë e jetë, por edhe të vret. Poeti di ta shpreh bukur me gjetjen metaforike edhe me anën e vargjeve të shkruara prej tij duke treguar rrugën e shpresave të jetës. Tharmi i pjalmit poetik të shkruar nga Mehmet Rrema frymon i thjesht, ai bën thirrje sublime tërë shoqërisë njerëzore për të mbjellë farën e mirësisë së Jetës! Pa këtë s’ka zhvillim e përparim shoqëria jonë.

Ne u ndalëm në disa prej poezive të këtij vëllimi për të kapur esencën e tyre edukuese e mesazhet që përcjellin për te lexuesi ynë i poezisë. Poeti Mehmet, ka ditur të përzgjedh tematikat dhe me ndjenjën e dashurisë e të shpresës i ngjitet majës së malit, e aty takohet me yjet duke shtruar tapetin e shpresave të të nesërmes. Në poezinë me titull ‘’Meditim’’ metaforat e krahasimet janë si një pjesë e atij gjerdani të art ku rrinë shtruar rrezet e diellit mbi det duke përkëdhelur valët e mëndafsha, ato lozin me pulëbardhat, ëndrrat e shpresave fluturojnë në breg ku dëshirat i ‘’Flenë’’ të qeta në fshatin e lindjes së tij. Kujtimet janë pjesë e asaj jete që ‘’Takohen’’ edhe me gurët simbolik të shkruar me epitafet e të afërmve atje në varre,i përkëdhel në qetësi

si një fëmi. Dhe ja si shprehet me vargje aq domethënse e drithëruese plot mall e dhimbje , por e me dashuri:

.....,
‘’ mbi varre të prindërve të mi.
Atje desha sonte të pushoj
ta mbështes kokën në qetësi,
dhe ata do të më përkëdhelin
prapë si atëherë,
kur isha fëmijë.’’.

Te poezia ‘’Trenat’’,vargu vjen i thjesht, ka lirizëm në ndërtimin e saj,por e ndërthurur me atë ndjenjë të brendshme që bën thirrje se si duhet të eci para tërë shoqëria e njerëzit drejt ardhmërisë e përparimit social në gjithë fushat e jetës.Poeti nuk i shmanget dot lëvizjeve akrobatike që bën shoqëria në planin socialekonomik e politik.Duhet patur shumë kujdes , - thotë poeti Mehmet Rrema, sepse shpejtësia të çon edhe në rrugën e gabuar e mundesh të bjesh në humnerë, pra treni kërkon mashinist të aftë e të dijë ku ta stacionojë atë ‘’tren’’ të zhvillimit socialekonomik e shoqëror për të kapur pranverën e jetës. Ja si e shpreh në vargje:

‘’Trenat le të jenë të shpejtë
dhe njerëzit po ashtu,
por kurrë në jetë,
të mos ecin kuturu!’’

Poetët janë të ndjeshëm ndaj fenomeneve shoqërore. Si të tillë ata s’munden dot të rrinë larg , por me guxim e mendje të mprehtë luftojmë me forcën e tyre të mendimit e të fjalës të shprehur me anën e vargut poetik. Ai shqetësohet e ndjen dhimbje deri në palcën e kockës, sepse kohët ‘’Moderne’’ sjellin edhe plagë shoqërore tek njerëzit, si rrjedhojë ato duhen luftuar me çdo mjetë, deri e me forcën e fuqishme të fjalës, siç është e magjishmja fjala e poezisë. Duke i hedhur një vështrim lexushmërie poezsë me titullin ‘’Dhimbje për një vajzë në rrugë’’, poeti Mehmet Rrema shpalos hapur uraganin e dhimbjes e të urrejtjes ndaj këtij fenomeni shoqëror social botëror. Ai nuk mund të heshti, por merr penën e hedh në letër vargun jetdhënës e që godet këtë fenomen e plagë të shoqërisë njerëzore. Ai bën thirrje mbarë shoqëror për të shëruar plagën e kësaj drithërime që vajzat gjenden të mashtruara e shesin trupin e tyre për pesë kacidhe te tutorët mashtrues të kohës gjoja ‘’moderne’’, por në fakt është mashtrim i hapur e skllavëres që shkatërron jetë njerëzish. Deri kur do vazhdojë kjo lotdhimbje e plagë e shoqërisë që shkakton edhe vdekje me jetë

njerëzore?! Kjo është një thirrje e fuqishme që bën poeti të cilit i del si një vullkan nga shpirti i tij. Më konkretisht:

……
‘’ Pranë rrugës, ti prapë
qëndro;
shpirtvrarë në shi,
ngricë
apo vapë.
Dridheshe ti,
si purteka në ujë,
ti vogëlushe,
dashnore e gjithkujt.
Dridhesh dhe kur bën vapë
Nga dhimbja jote,
tym nxjerrë toka
tym e zjarr
digjet bota.’’

Edhe te poeazitë me emra të përveçëm autori ka shpalosur atë ndjenjë të brendshme, të cilat s’mund ta anash kalojë lehtë me vetveten, ai gjen në kopshtin e krijmtarisë së tij gonxhen e dashurisë për njerëzit e zemrës. Ngjyrat e ylberit, melodia e fyellit,stina e motit,lulet e majit,flladi i detit,mali me bardhësinë e borës te maja e Çikës, ujrat e Shushicës, shkëlqejnë si drita e diellit për njerëzit e zemrës së poetit, siç është Havaja apo Nika etj.

……..
‘’ Kur agimi, zbret në tokë të zotit
Me gjithë shkëlqim e hijeshi
O Hava derëhapur përherë.
Si ninanullë Shushica
Në këmbët e fshati
Ëmbël rrjedh në shtratin e tij
Hua nga ti ëmbëlsinë e mori
Dhuratë ta çojë tek çdo njeri. ‘’

E vërteta ...të thush të vërtetën në çdo kohë do guxim, dije e sakrificë, sepse e vërteta kuptohet me vështirësi e godet fort fenomenet e këqia të jetës e të shoqërisë.Si rrjedhojë, ajo kuptohet nga të tjerët me shumë vonesë, sepse të vërtetën e thonë në sy vetëm njerëzit me vizione largpamse, pa frikë e konjuktura, pavarsisht se ajo i shkaton plagë në

shpirt atij që e thotë këtë të vërtetë (nga keqkuptimet).I tillë është edhe poeti Mehmet, i cili e thotë pa frikë këtë të vërtetë.Te poezia ‘’E vërteta’’, konkretisht na jep këto vargje:

……
‘’ Ja thashë të vërtetën lules se prillit,
ajo e ktheu në aromë.
Ja thashë të vërtetën zogut të malit,
ai e ktheu në këngë.
Ja thashë të vërtetën ariut,
ai më tha
“Mos deshe të bëhesh Promete”?
Ja thashë bariut –e ktheu në bujari.
Dola në shesh duke thënë të vërtetën,
njerëzit ikën të frikësuar,
sikur ajo fjalë botën do shembi.
Ua thashë politikanëve,
ato u sulën kush ta vriste i pari.’’

S’ka poet në botë që të mos ketë shkraur qoftë edhe një varg të vetëm për Nënën.E si mund të mos hidhte në letër vargun e ngrohtë të gatuar me lot e baltë të vendlindjes poeti Mehmet Rrema për të shtrenjtën Nënë! Loti për prindërit nuk gjen tharje kurrë! Ai është si një lum që nuk shteron asnjë herë.Lexon vargun për nënën, e shpresat marrin fluturim drejt shtigjeve të pashkelura si një shpend shtegëtar në fluturim.

.....
‘’ E unë shtegtoj,shtegtoj pa pushim,
Përpara meje e panjohura
Nga pas nëna e përlotura....’

‘’ Endem nëpër paralele e meridiane
Si merimanga në pëlhurën e saj
Dua tërë botën ta pushtoj sonte,
Por qenka e madhe, e madhe
por jo;
Sa Zemra e një Nëne!...’’

...Por ai kërkon edhe një emër tjetër që plagën e zemrës të mos ja lëndojë njeri. Ai kërkon atë emër tjetër aq të dashur që ne i themi të gjithë Baba! Vargu është ndërtuar deri në lartësinë qiellore....!

‘’E dua lartësinë e qiellit

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

siç dua dritën e diellit
e dua forcën e fjalës
që ma nderon emrin e babës.’’

Me plot metafora të gjetura e shumëplanshe i gjen edhe te poezitë ‘’Fjala’’, ‘’Kënga e emigrantit’’,’’Vajzat e vendit tim’’,’’Bariu’’ , ‘’Në galeri’’,’’Përshëndetje Mirditore’’, etj.

Vëllimi poetik me titullin aq domethënës‘’Valixhet e shpresave’’ka në vetvete plot figura letrare,saqë ato formonizojnë atë gjerdan vijushmërie për ta lexuar deri në fund çdo poezi. Poezitë të mbajnë të mbërthyera fort pas vargut e të thonë ‘’Lexomë deri në pafundësi!’’. Duke lexuar poezitë e këtij vëllimi, ke prekur e lexuar gonxhen krijuese të shpirti të poetit Mehmet Rrema. Poeti na përcjell me filozofinë e poezive ato mesazhe që burojnë nga brendia e shpirti të tij, të cilat na nguliten fort në memorjen tonë e nuk shqiten lehtë.Ato mesazhe marrin udhën e shpresave nëpër labirinthet e jetës e s’ndalen kurrë, ecin udhëve të pafundësisë kozmike!
Dhe vargjet e stolisë poetike te vëllimi ‘’Valixhet e Shpresave’’ të poetit Mehmet Rrema vargëzojnë plotë shpresë se...,

‘’ Ne jemi sfera e hedhur që bie mbi birila
Nëse i godet, i fituar do të jetë, ne se jo i humbur.
Ne, herë sferë, herë birilë, bëhemi lodër
Në lojën e egër te jetës që loz me ne
Si era me gjethet e vjeshtës.’’

Na mbetet për ti thënë librit e poetit:Udhë të mbarë!.

Xhevahir Cirongu

Poet

Durrës, Gusht 2018

NE

Kur shkrepin rrufetë, i lutemi Zotit
Kur bie shi a bën vapë – shajmë atë,
pse kundër nesh e drejton motin.
Kur kemi para, lëvdojmë pushtetin
të varfër kur jemi mllefosemi.
Egoistë, egoistë për gjithçka,
ta kem unë të mirën që tjetri ka!
Të urtë të drejtë kur jemi sëmurë
si kameleonë ndërrojmë shtatë lëkurë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

PYETNI PËR MUA

Nëse do të të pyesni për mua;
kush kam qenë e nga kam ardh'
pyesni, por
jo për hallet e mia,
sepse,
ato askujt s'dua t'ja fal.
Kam lindur duke qarë
ashtu edhe mund të vdes,
Por në gjunjë nuk bie,
edhe sikur këmbët t'i pres.

DO TË MË GJENI

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Në se një ditë do të më kërkoni
do të më gjeni atje, në mal;
duke thithur aromën e pishave,
luleborën duke e bërë kurorë,
duke pirë ujin e ftohtë të krojeve
në hijen e ahut,
në prehrin e erës,
në ëndrrën e vjetër
atje do të më shikoni.
Në se një ditë do të më kërkoni,
dhe s'do të më gjeni;
pyesni për mua ariun,
mysafir tek ai do të jem;
të mirë miq do të thoni!
Në se një ditë do të më lypni
e s'do të më gjeni;
mos qani o njerëz
i lumtur do të kem vdekur
bashkë me ëndrrën e vjetër
Në tokën e etërve,
Dhe për këtë gëzohuni!

TË FALEM O PERËNDI

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Të falem o Perëndi
që më dhe sy,
të shikoj lindjen e diellit
e perëndimin e hënës,
blerimin e fushës
e shkrirjen e dëborës,
buzëqeshjen e fëmijës
e dritën e xixëllonjës.
Të falem o Perëndi!
Të lutem o Perëndi
mos më lejo të shikoj
se si vriten njerëzit,
se si fshatra e qytete
po zhduken
nga luftëra, tërmetet, uria.
Të lutem o Perëndi!
Mbyllmi sytë
të mos shikoj asnjë tragjedi.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

MEDITIM

Dielli kokën ulur ka mbi det,
rrezja përkëdhel të mëndafshtat valë.
Si pulëbardhë e harruar në breg rri,
Vështrimin kam tretur atje larg,
Ku disku i diellit del ngadalë.
Do të desha të isha zgalem,
detin ta kaloja fluturim.
Të ndalesha në tjetrin breg
rrezet t'i shikoja sa bukur bien.
Kam dëshirë të jem në fshat,
atje ku më thonë gjithë mirësi,
hajde, vëlla sonte për darkë,
ta kthejmë një gotë raki.
Të shikoj lindjen e diellit
që ëmbël zbret nga mali
si vello mbi flokët e vajzës,
në kalin e nusërisë,
dhe ec përkrah djalit.
Ta pres mbrëmjen,
në fshat të vijë
dhe freskun e purpurt lëshon
aty,
mbi varre të prindërve të mi.
Atje desha sonte të pushoj
ta mbështes kokën në qetësi,
dhe ata do të më përkëdhelin
prapë si atëherë,
kur isha fëmijë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

NE DHE ZOTI

Kur bie shi
rëndohet trafiku.
shoferët shpalosin fjalorin e rrugës.
Shajnë njëri tjetrin,
rrugën,
shiun,
shtetin,
shajnë edhe Zotin.
Zoti hesht!
Dëgjon dhe hesht.
Vetëm nganjëherë
psherëtin i dëshpëruar.
Dëgjon dhe hesht,
a thua një ditë do të hipi
mbi majën e Olimpit
e do të bërtasë me tërë forcën:
përse të krijova o i mjeri njeri?!

DËSHIRA E NJË TË HUAJI

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Ngado që shkoj sjellë me vete
këngët e mia.
Dua që jehona e tyre të përhapet
si aroma e luleve të pranverës
 së vendit tim;
e të mbushi zemrat e njerëzve
me dashuri.
Ngado që shkoj
sjellë me vete ëndrrat e mia.
Dua që ato t'i japin krah
lulëzimit të dashurisë.
Ngado që shkoj
sjellë me vete vuajtjet e mia
dua që ato të mbeten në mua,
si i vetmi bashkë udhëtar
që kurrë nuk m'u ndanë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

TRENAT

Trenat le të jenë të shpejtë
dhe njerëzit po ashtu,
por kurrë në jetë,
të mos ecin kuturu!
E urrej plogështinë dhe dremitjen,
ashtu si rrëmbimin e lajthitjen.
Njerëzit dua të ecin veç përpara
Se nesër nuk vjen e sotmja
Të shpejtojnë ashtu si koha
drejt ardhmërisë pa përtim,
si dallëndyshet që pranverën,
e gjejnë në shtegtim.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

LUMI I VENDIT TIM

Në vendin tim rrjedh një lumë.
Lumë lotësh,
lot nënash e motrash,
vajzash të dashuruara,
nusesh të pa nusëruara.
Rrjedh një lumë që thanë fusha
plas tokën,
thyen gurin,
U thafsh more lumë!
Në vendin tim rrjedh një lumë,
lumë gjaku,
gjak baballarësh,
gjak burrash,
gjak djemsh të dashuruar;
u thafsh mor lumë!
Në vendin tim rrjedh një lumë
lumë vuajtjesh të pa fund,
urrejtje,xhelozie, hakmarrje
u thafsh more lumë
1997!

DHIMBJE PËR NJË VAJZË NË RRUGË

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Me ata sy të bukur si ulli
mbi tokë lëshuar.
Tokës i thoshe:
hapu dhe më përpi.
S'të dua më o jetë,
nuk të dua ty.
As dritë e as diell
nuk pashë me sy.
Pranë rrugës, ti prapë
qëndro;
shpirtvrarë në shi,
ngricë
apo vapë.
Dridheshe ti,
si purteka në ujë,
ti vogëlushe,
dashnore e gjithkujt.
Dridhesh dhe kur bën vapë
Nga dhimbja jote,
tym nxjerrë toka
tym e zjarr
digjet bota.
Qielli nxin,
loton dhe bërtet.
Ndoshta vetë zoti
në qiell bërtet.
Në një tjetër vend,
ku dielli më shumë ndrin.
Shpirtkëputur
nënëzeza jote
hesht ,
dhe shpluhuros
lodrat tuaja
mbi komodinë.
Në gjoksin tënd
të llahtarshmet duar
si tentakula
përbindëshi
kërkojnë të prekin
gjirigjoksin,
ku formuar
ende s'të është gjiri.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Ti ndjen dhimbje,
ndjen të pështirë,
dhe lot që djegin
te lëshon syri
çfarë kërko ai
ndoshta
dhe mirë nuk e di,
Vetëm ai pas ferre
Shikon e përgjon në qetësi
Një birrë në dorë
Pi dhe
rri i shtrirë.
Loti yt i nxehte mbi tokë bie
E toka nga dhimbja gjëmon.
ulërin, rënkon, mallkon.
Toka plasaritet,
digjet ,
përvëlon.
Toka kalë i gjithkujt
Pendohet për kalorësit e saj.
Ndoshta një ditë
Lubi do të bëhet ,
dhe në barkun e saj
të zjarrtë
hi do t'i bëjë.
Zoti shikon dhe hesht.
A thua dhe ai trembet
nga krijesa e vet,
apo para vetes skuqet
dhe turpi e vret?
Kalimtarët shikojnë.
Dikush me ty qesh.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Dikujt lotët i gëlojnë
dhe dhimbje në shpirt ndien.
Dikush mrrolshëm psherëtin
fytyrën gërvisht dhe nxin.
Ti e di. Po, po, mirë e di,
çfarë do të thotë ai.
Pas ferrës ai ruan.
Përgjo

"Klientët" numëron
dhe po e kundërshtove,
apo...
lekët të mos ja çosh në shtëpi,
nesër dritën, s'do ta shikosh
o e mjera vajzë ti.
Di, ti vogëlushe, di gjithçka,
veç fatziut, i yt s'ka sy me pa.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

NADJA

Sytë e tu,
unë
s'i kisha parë.
Ishin
të kaltër
apo
të zi,
por e di,
se ishin
më të bukur se qielli
se ylli
se ulliri.
Ata ishin
më të bukur
se deti
që ta shuaj
shikimin .
Shikimi yt
ishte
më i shpejtë se
rrezja,
më i thellë
se deti
që
të përpiu…
Sytë e tu ishin
plot
ëndrra ,
shpresë
dritë .
Ata sy, nuk i kisha parë
Vogëlushe,
por
e dij
se
flisnin më bukur
se poetët,
se oratorët,
se politikanët
Nuk ta kisha parë gushën
Vogëlushe

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

por e di,
se ajo
kishte marrë
bukurinë
e
lules së pranverës.
Zërin tënd nuk e kisha dëgjuar,
por
e di se ai
ja kishte marrë këngën bilbilit.
Ti ike
ndoshta
shoqeve pa u thënë
sepse
ike shpejt
si reja me shi.
Ike
kur
ende mbushur nuk i kishe
tetë pranverat,
dhe shoqeve
u mungove
kur vendi bosh
qëndronte
tek banka.

Ndoshta
ndonjëra
të pati zili
dhe tha:
Lum ajo!
Ti ike ngarkuar
me ëndrra,
dëshira
plot me…
Ike drejtë
të panjohurës
të shumëpërfolurës
të lakmuarës…
parajsës… së rreme.

Ti ike drejtë

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

…vdekjes.
Sapo vure këmbën
në të mallkuarën
u rrëqethe,
u dridhe,
u trembe,
ndoshta
edhe të ktheheshe
deshe.
Shpirti yt
ndjeu
diçka gati
të tmerrshme
por nuk munde
ta përcaktoje
në se drejtë
lumturisë
a vdekjes
shkoje.
shoqet tua
ashtu
të varfra
por,
të dashura
me këpucë
të çara,
rroba të vjetra
vazhdonin të loznin
dhe për ty
merakun e kishin.
Kishin menduar
edhe për dhuratën;
një tufë me lule
dhe
një lodër
për ditëlindje
tënde kishin blerë
dhe ashtu,
paketuar siç dinin ata
donin ta postonin ty.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Por,
askush nuk e dinte
se ajo dhuratë
një ditë
bashkë me tufa lulesh
tek ti nuk do të arrinin,
por në det
në shenjë kujtimi
për ju
do t’i hidhnin.

AJO GRUA MË SHPIRT KRISTALI

(H A V A SË)

Kokën lart, mbi Majën e Çikës
Shpirtin kristal
si burimet e Shushicës.
Balli yt, dritën ia ka marrë hënës
zemra, bardhësinë dëborës.
Në sytë e tu, ëmbël vjen pranvera
Dhe lule çel me njëmijë ngjyra,
Kur mysafiri të troket tek dera
Hajde, thua, të ardhtë e mira!
Fjala mëndafsh
me shtatë ngjyrat e ylberit
E lehte si vello e nuses përkrah djalit
Partiturë për melodinë e fyellit
Porsi rrezja e parë e agimit
kur bie ëmbël mbi vesë të mëngjesit,
E ashpër e butë si vetë stina e motit
Plot hir e aromë si lulet e majit
Si flladi i lehte i bregdetit
Kur agimi, zbret në tokë të zotit
Me gjithë shkëlqim e hijeshi
O Hava derëhapur përherë.
Si ninanullë Shushica
Në këmbët e fshati
Ëmbël rrjedh në shtratin e tij
Hua nga ti ëmbëlsinë e mori
Dhuratë ta çojë tek çdo njeri.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

GJAKMARRJE

Trishtueshëm fëmijët
në heshtje tragjike
qëndrojnë,
dhe
frymë kanë frikë të marrin.
Kërcënueshëm qëndron pas gardhit
dikush me pushkën në sy
që pret
në më të parin rast
ëndrrat e tyre,
me një copë plumb të zi,
t'ua kalli në arrati.
Zemër dridhura nënat
ruajnë dhe shikojnë çdo vrimë
dhe hijet u ngjajnë si ai,
atje prapa kthesës
në çdo skutë
e në çdo skaj
tek përgjon
me pushkën mbështetur në sup
dhe syrin në shënjestër.
Ata dinë se,
Inkandeshenca e atij plumbi,
në diellin e pranverës
apo në stuhinë e natës,
në ditën e festës
apo ne çastet e dhimbjes,
pamëshirshëm
do t'ua përvëloi zemrën.
dhe fëmijët e tyre
do t'u ngjajnë
luleve që breshëri këput
sapo kanë nisur të çelin.
Ata presin me dhimbje ditën
të dalë
dhe natën të bij.
Oh !
Jemi kthyer në kohërat arkaike
kur varur tek koka qëndronte qefini!

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

SEKRETE

Sekretet, në zemrat tona
peshojnë rënd
E shpirtrat na fryhen
nga pesha që mbajnë,
por vjen një ditë
që shpërthejnë si çibanë,
përhapen kudo dhe
zemrën na e ndajnë.
Nuk e dimë,
në se nga ky shpërthim
do të brohorasim nga gëzimi
apo do të shfryjmë
dhe të vetë mallkohemi,
të vetë mallkohemi që s'mundëm;
tonat ato t'i mbajmë.
Por dimë, dhe këtë s'e harrojmë
që kur tonat s'do të jenë më,
Ne,
si fëmijët pas fluturave
do të vrapojmë,
diçka tjetër për të zënë.
Dhe në zemrat tona për ta ngujuar
sepse ne kemi gjithmonë
diçka për të thënë,
diçka për të mos thënë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

NE NUK ISHIM ASGJË

Kemi besuar ideologjinë;
në dreqin e të birin kemi besuar.
Harruar e kishim Perëndinë
dhe veten tonë e patëm mohuar.
Dielli ndriçonte vetëm për ne;
botën kishte pllakos errësira.
Pak dritë,
ajër,
shpresë
do të merrte veç nga Shqipëria!
Ne ishim pishtari,
timoni,
kushtrimi,
ne për botën ishim shpëtimi!
Por ne,
ne, nuk ishim asgjë;
veç mbuluar ishim
në sllogane vetëmashtrim
dhe me to parajsën ndërtonim.
Dhe me to,
botën drejtonim.
Dhe erdhi një ditë
kur ne u ngritëm
nga bota të izoluar
në strofkën tonë.
Ne ;
 e ne luftonim me armiqtë
 që kurrë s'i pamë!
Me armiqtë që kurrë
s'e shkelën pragun tonë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

PLAKU NIKOLLË

Plaku Nikollë ishte me një dorë,
por mendjen e kishte të hollë.
Derën hapur e zjarrin ndezur
pushkën varur gjithmonë ngrehur.
Për mikun nuk i qe shkrehur sofra
edhe në ditët më të ftohta.
Mjaltë nxirrte nga goja
dhe qeshte e bënte ojna
Lalë Nikolla.
Gjithmonë më thoshte një fjalë:
Kujdes more djalë!
nga ato, që kush s'u thotë
puna e mbarë!
nuk kanë besë e fe,
s'njohin nënë e atdhe.
për një grosh të vënë në litar
Në dorë po u re,
thikën pas shpine e ke
Kështu më pat thënë kohë më parë
sikur e dinte se kjo ditë,
sot kishte me erdh).

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

SHPIRTË I VETEMUAR

Shpirte i vetmuar,
mes vuajtjesh e dëshpërimit,
mes dhimbjes e përçmimit,
në skaje të errëta të harrimit,
ku ditët janë më të errëta si nata
dhe stinët të ftoha e të lagëta,
Zgjohu!
Shpirte i harruar
mes shpresave të mekura,
mes shpresave të vetënuara ,
në vuajtje zvarur,
si zog krahë thyer mbetur në vetmi,
ku dhuratë nga jeta more vetëm
lot në sy,Çohu!
Shpirt i trazuar
mes shpresës e ëndërrimit,
ku ditët kanë peshën e plumbit
dhe netët atë të dhimbjes,
kur dielli të perëndoi
e hëna të puthi majat,
ngrihu dhe ti, e bashkë
me dragonj e zana,ndalojeni këtë botë,
që vetveten në urrejtje ka kall,
në gjemba rrugën ka shtruar
deri në theqafje .

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

PRITJE

Kam pritur një ditë
të lindi dielli,
të shkëlqejë ylli,
të jeshilojë pylli.
Kam pritur një ditë
sa shumë kam pritur
LIRI!
Zemrat tona me na i ndrit!
Dhe ti erdhe me krisma e rropamë
kur vatrat tona në gjak u lanë
sa trima për ty jetën e dhanë!
Por në gjunjë kurrë nuk ranë.
Liri,
sa shtrenjtë të paguam!
Kemi pritur me muaj
kemi pritur me vite
kaq shumë të ëndërruam kaq shumë,
kur një ditë yjet nga majat zbritën
çfarë ëndërr të bukur thamë
sa syve besë s'u zumë,
por ti kishe ardhur vërtetë
mes nesh plot madhështi
e ne nisëm një tjetër jetë
me ty e paçmuara LIRI!

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

MYSAFIR TEK SHQIPET

Mysafir dua të jem
në çerdhen e shqipeve
aty ku delli ndrit më shumë.
T'i përkëdhel kreshtat e maleve
si nëna kokën e fëmijës në gjumë.
Kur horizontin ta skuqi delli
e tufat ta lënë kullotën,
ta falënderoj Zotin e qiellin
e me shqipet të ulem në sofër.
Ta dëgjoj këngën e tyre piskamë
si malësori kur ja merr maje krahut
Sokolat në tjetrën anë,
ëmbël kuvendojnë pranë oxhakut.
Të dal natën tek kroi,
në hije të lisit plak,
të shoh shtojzovallet tek lozin
e tundin të bukurin shtat,
në flladin e lehtë të bjeshkës,
në dritë argjendi të hënës,
me të bardha veshur-o,oo
më të bukurat e botës.
Kur nata të jetë thelluar
e kudo të ketë rënë qetësi
mbi fierin e njomë dyshek shtruar,
të fle plot kënaqësi.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

A THUA SHPIRTIN TA KAM VRARË

Kur isha i vogël kam qenë çapkën
Nuk di pse, por nuk zija vend askund
Dhe sot,
Unë një shpend shtegtar
Në fluturim të pafund
Shoh fusha të gjëra e male të larta
Dhe shpesh përpara
humnera të thella.
E unë shtegtoj,shtegtoj pa pushim,
Përpara meje e panjohura
Nga pas nëna e përlotura.
Unë prapë në rrugëtim
Kjo jeta ime si një mallkim!
Unë shtegtoj,shtegtoj pa pushim
O nënë! Veç ti m'i jep jetës kuptim.
Unë shtegtoj
Jeta më është një luftë,
Zemra djegur e shtatë herë çarë
Për ty oj nënë!
Lotët kurrë,
THARË!
Zemra po më shkulet,
Dhe lotët nuk i mbaj
Njëmijë herë më përcolle,
Por unë erdha prapë
Kur unë të përcolla

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Ti u ngjite lart
Lart u ngjite moj nënë
Mes yjeve ndriçon.
Ah, për ty moj loke
zemra më është
plasaritur e
ÇARË.
Endem nëpër paralele e meridiane
Si merimanga në pëlhurën e saj
Dua tërë botën ta pushtoj sonte,
Por qenka e madhe, e madhe
por jo;
Sa Zemra e një Nëne!
Më fal oj nënë që
Në ditët e fundit prenë teje
Nuk tu gjeta
Dhimbjen me ta lehtësuar
Flokët duke t'i fërkuar.

KUR LINDE TI

Kur linde ti,
Pemëve u erdhi lëngëzimi,
njoftonin gjallërimin.
Zogjtë këndonin;
Prapa kishin lënë dimrin
njoftonin pranverën.
Kur linde ti dielli ngrohu shumë;
mali e fusha lulëzuan.
Kur linde ti nëna më tha:
“Ka lindur një djalë
me pushkë në krah”
Kur linde ti unë të thashë
“Të dua shumë”!

E VËRTETA

Ja thashë të vërtetën lules se prillit,
ajo e ktheu në aromë.
Ja thashë të vërtetën zogut të malit,
ai e ktheu në këngë.
Ja thashë të vërtetën ariut,
ai më tha
"Mos deshe të bëhesh Promete"?
Ja thashë bariut –e ktheu në bujari.
Dola në shesh duke thënë të vërtetën,
njerëzit ikën të frikësuar,
sikur ajo fjalë botën do shembi.
Ua thashë politikanëve,
ato u sulën kush ta vriste i pari.
Njerëz !
Mos u trembeni nga e vërteta
Si djalli nga temjani!

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

SHKO TEK LALA

Ecte ngadalë më shkop në dorë
Ngadalë fliste edhe në kuvend
ishte i urtë plaku NIKOLLË.
Moshatarët e pyesnin për mend,
Në ke problem thoshin; shko tek lala,
tregoi hallin fille e për pe,
se atij shumë i peshon fjala;
dy fjalë me të jo nuk i ke.
Më pat thënë dëgjo mor djalë,
sot një fjalë e thotë gjithkush,
por është mirë ta peshosh më parë,
se fjala e lehtë trastën s'ta mbush.
Nga unë mbaje mend këtë fjalë
''Gjella më kripe kripa më karar''
Kujdes shumë çfarë nxjerr nga gjuha
Se fjala,djalë,
vret më shumë se pushka.

NJERËZIT

Thonë se njerëzit lindin
duke qarë;
dhe duke qarë vdesin.
Nuk di
në se emigrantët do të vdesin
duke qarë apo duke qeshur?!

NJË VAJZE

Rëndë - rëndë ecën si princeshë,
kapele në kokë, minifund ke vesh.
Ke hak; ke ardhur nga tjetër vend.
Ke marrë shumë "kulturë"
s'pyet për askënd,
as për babë e nënë
që në vatër kërcunj ke lënë.
Një letër s'ua shkruan
e nuk ua dëgjon as zënë.
Nuk begenis bre jo, hiç mos e thuaj,
a thua se je bijë e tjetër kujt.

MA JEPNI NJË EMËR

Mos ma ngulni thikën në zemër
dhe plagët mos m'i lëndoni.
Ma jepni vetëm një emër,
çakall e dhelpër mos më thoni.
E dua lartësinë e qiellit
siç dua dritën e diellit
e dua forcën e fjalës
që ma nderon emrin e babës.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

FJALA

Fjala e thënë
mund të ndërtoi një botë
ose ta shkatërroi atë.
Njerëz, kudo, anë e mbanë,
mendohuni para se fjalës
t'i jepni udhë sepse
ajo që e nxori
për të nuk ka më vend!
Fjalën e pa thënë
askush nuk mund ta komentoi.
Ajo ,
qëndron e fshehur në zemrat tona
për të shpërthyer një ditë
si lulet e pranverës së hershme,
apo një lule që lidh fryte.
Fjalën e dhënë
Mos e moho,
Në se do të quhesh njeri.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

SHPRESA VDES E FUNDIT

Çdo ditë e varros një shpresë
dhe më lind një tjetër.
“Shpresa vdes e fundit”
thotë një fjalë e vjetër.
Një rrugë më mbyllet për ditë
e unë një tjetër hap.
si syri që kërkon dritë
rrugëve të jetës ngas me vrap.
Rrugët tona plot ferra e gurë
e ne prapë s’ u ndalëm kurrë.
themi se kur ngasim me vrap,
jetën kemi zgjat.
Ne ngasim, ajo na gjuan me gurë,
herë rrugët na i mbyll,
por ne s’ndalim së renduri
drejtë saj në fushë e pyll.
Nuk di,
Pse jeta u dashka kaq shumë.
Jeta jonë
Sa shumë shpresa
Shpresa të humbura!
Sa shumë lule
Lule të vyshkura!

JEMI RRITUR

Jemi rritur
duke pirë qumështin e deleve
duke dëgjuar gumëzhitjen e bletës
luleshqerrat duke i bërë kurorë
duke bërë burra me dëborë.
Jemi rritur mes besës dhe fjalës
jemi rritur e jetojmë,
Për të nderuar emrin e babës.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

LYPËSAT

Nëpër rruge lypsarët nuk i dua;
jo pse nga njerëzit kam neveri
kur i shoh tek zgjasin ata duar
them këtë botë në satër ta grij
“Zotëri më fal ndonjë lek,
më fal zotëri”!
“Jam…
Më fal të lutem se kam uri”!
Pranë semaforit,
me kokë lëshuar në tokë
pa lëvizur aty qëndron
në vapë, ngricë,dëborë a shi.
Aty qëndron i mjeri fëmijë
këmbëzbathur e me barkun që i gri
me sy drejtë qiellit Zotin mallkon.
Padronët nëpër kafene
pinë uiski fernet branka e pale!
Sa mirë kur paraja
duke ndenjur të vjen!
Ik që këndej o i ziu fëmijë
Se një ditë do të rritesh ,por
Kështu nuk bëhesh njeri!

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

NË SE DO TË TAKOHEMI

Në se një ditë rrugës duke kaluar
përballë do gjendemi pa pritur,
e di kokën do ulësh e turpëruar
do të ikësh veten duke pështyrë.
Më kishe premtuar dashuri
besnike në eter
se as dheu ne të dy
s'do të na ndante asnjëherë.
Ti qeshe atë ditë.
Ooo, sa shumë ke qesh!
Nga gëzimi fluturove
se pranë më s'do t'më kesh.
Ti nuk e njihje dashurinë
për ty ajo s'kishte rëndësi
mjafto që në shtrat të shtriheshe
në ekstazë duke u zgërdhirë
Por jeta s'ka veç lumturi,
të gëzosh është më e mira
jeta ka shumë lule dhe ngjyra
dhe më e bukura-Dashuria.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

UNË DHE DETI

Para meje ulur si hëna buzë malit
me sy si det i thellë e i qetë;
sytë e mije zbresin drejtë teje
aty ku zemra pa pushim rreh
mbi gjoksin tënd që ngrihet
si dallgët që përplasen në breg.

O perëndi,që ke krijuar gjithësinë
dhe jetës i fale hijeshi,
jepmë dhe mua pak qetësi
të përballoj këtë ndjesi.
Kjo botë kështu sa lumenj e male
sa shumë vuajtje,urrejtje e halle,
po pse të lutem, pse o Perëndi
njeriut i dhe kaq ligësi?
Pse nuk e mbushe me dashuri?
Ulur pranë teje shikoj ty dhe detin
dhe them me vete
(Sa shumë ngjani me njeri tjetrin!)
Deti ngjyrën e syve të ka vjedhur
Dallgës ti ja ke marrë hovin
Mbi ne purpur dielli i mëngjesit
Lëshon rrezet që na ngrohin.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

NGJASHMËRI

Pasqyra e thyer,
Në njëmijë copa ndan fytyrën time.
Fytyra ime
I ngjan zemrës sime;
Zemra ime
I ngjan jetës sime
Jeta ime-katër mijë copa thyer
Në rrugët e jetës duke vrapuar
Zemra ime rend
Nga jugu në veri,
Nga lindja në perëndim
Diellin për të takuar.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

FSHATIT TIM

Ah, kur ta puth dielli ballin
dhe fresku ta ledhaton trupin,
i bukur fshati im, i bukur.
Vetëm ti ma shuan mallin.
Mali të rrinë tek koka
tek këmbët liqeni.
O fshati im i bukur
më i miri i këtij vendi.
Të bukur aromë sjell toka
kur bujqit e mbjellin.
Kur lulëzon molla,
kur blegërin qengji
i bukur fshati im i vogël,
më i bukuri i këtij vendi
Kur vjen Shëngjergji
e pyllin marrin shqerrat
i bukur , fshati im, i bukur
kur vlagojnë të mbjellat,
kur presim dushkun,
kur vjelim mollën,
kur ziejmë mushtin
dhe hedhim vallen
nuk të ndërroj
as me të gjithë botën.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

KËNGA E MËRGIMTARIT

Në dhe të huaj asgjë s'është e mirë
bilbili nuk këndon,lulet s'kanë erë;
nata është e gjatë dielli s'bën dritë
errësira e natës
thellë më hyn në shpirt.
Rri e mendoj për vendin tim
për atë vend ku çdo gjë më shijon,
për ato kodra fusha e shkrepa,
ku më e ëmbël më duket jeta.
Ngrita dorën lart drejtë qiellit,
se desha të prekja rrezen e diellit.
Me një zë të ëmbël ajo më tha mua
shko në vendin tënd për të më takuar.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

VAJZAT E VENDIT TIM

Duke kaluar nëpër rrugët
e një qyteti në perëndim,
Pashë një vajzë që ecte me nxitim.
Ajo vajzë më përngjau shumë
Me vajzat tona
kur shkonin në punë.
Ngadalësova hapin u ndala ta pyes
Vajzën nga je të lutem më thuaj
Se rrallë kam pare si bukuria juaj.
Në fytyrë u skuq, e nuri iu shtua,
buzagaz si manare m'u afrua
dhe më foli plot ëmbëlsi
siç flisnin dikur vajzat në Shqipëri
"Dhe mua me ke andej nga vjen ti"
Oh sa i shkëlqeu syri si ulli!

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

RILINDJE

Kur shpirti takon shpirtin
Vibrojnë zemrat
Në trup kalojnë mornica
Sytë shkëlqejnë
Trëndafilat çelin
A thua rilind jeta?

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

QESHJE

Ndoshta qesh!
Ndoshta ndokush qesh,se këtu,
të qeshësh është pothuaj e pamundur,
në se vërtetë nuk je i marrë.
Ose ndoshta të mos qashë,
Të tjerët do të thonë
“i lumtur qenka ky “.
Lumturia- Ëndrra e madhe
Lumturia-pronë e disave
Që sot qiellin kanë pushtuar
Dhe…
Qyteti lëviz.
Në lëvizjen e tij kaotike
ka veç zhurmë;
ka baltë, pluhur, plehra që
kundërmojnë erë jashtëqitje
e ne, ne,ne...
në katrahurën tonë marramendëse
thithim çdo ditë çdo natë madje,
edhe në gjumë
atë që gazeta na servirin
atë ku flitet për gjithçka
kronika të zeza, u vra, e vrau,
e grabiti, e rrëmbyen
e dhunuan, e shqyen
flitet për vipa.

Kronika dashurie
aq sa të zë frika,
aq sa na zë frika,
aq sa na vritet zemra
aq sa na luan mendja
për punë e bukë
nuk i gjenden dy rreshta.

NUK E DUA PARAJSËN

Jeta peshon në zemrat tona
si guri i pendesës,
mbi të dënuarin pa faj.
Më kot shpresojmë në falët e hoxhës
“Vuani në këtë botë,
që parajsën të gjeni kollaj”.
Jo! Nuk e dua parajsën.
Mbi zjarr të ferrit do të hidhem vetë.
Sot dua të drejtën
Asgjë për tjetrën jetë.
Sot të ngjitem në majë të jetës
duke çarë në flakë e stuhi
t’ja dëgjoj shijen së vërtetës
pa nesër tjetër ditë do të vijë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

PARTISË SË PUNËS

Dashuruar ishim në fjalët e tua
si sokolat në shtojzovallet.
I besuam më shumë se perëndinë
për to do falnim tonën, rininë.
Ti rriteshe dhe mbushje hapësirat
Në ne bota kishte vend vetëm për ty
U rrite shumë por
humbe madhështinë.
Si pemët kur gjethet u bien.
"Internacionale do të jetë bota e re"
E dashurova gjer në pafundësi
Me to ngriheshim flinim me to
lindi dhe rriti njeriun e ri;
lindi heroin që botën "ndrysho"
Ti vazhdoje luftën e klasave
E pa ndërprerë shtoheshin "armiqtë"
Luftoje sabotatorët
Ato shtoheshin çdo ditë"
Hajdutet dembelet imoralet…
Ty t'i shitua radhët
Derisa një ditë ata ishin të paret
E në K. Q. p. p. sh.
Në vend të veprave
Shikonim sllogane
"Shqipëria nuk është
as lindje as perëndim"
Ne "pishtarët"në errësirë
Pa kuptuar humbëm krenarinë.

Dhe erdhi një ditë me diell a stuhi
Atje në Tirani ku kishe lindur .

Aty u vendos
Të vdisje ti.
Si kërpudhat pas shiut

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Do të lindnin në hapësirat tona
Parti,
Grupe,
Rrugë,
Rryma,
Ide të reja.
Parti ,të majta të djathta
Të kuqtë verdha e kush e di;
Por ,
partitë s'janë lodra për fëmijë
Ato
Si përrenj të rrëmbyer
Mund të shkatërrojnë gjithçka
Ato
nuk ndërtojnë, por vetëm premtojnë.
Ato janë lumë i tërbuar që sjell
Në shtratin e tij
    Kameleonë,
        Krokodilë,
            Gjarpërinj me shtatë kokë
Të zhytur në llumin më të zi,
Kërkojnë gjak
    Gjak njeriu
        Djersë,
        Djersë punëtori;

Por në atë lumë
Mund të lundrojnë
Anije të mbushura
Me xhevahire e thesare.

Dhe turmat,
Si delet pas çobanit
Lëvizin humbshëm në lojërat e fatit
Drejtë lumturisë a mjerimit.
Partitë shtohen
E,...
Në zemrat tona ndizen zjarre
Në zemrat tona lindin djaj me
Shtatë krerë, vampirë e kuçedra
E ne fryhemi nga urrejtja
për farën tonë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

PEJSAZH

Qielli është mbyllur i tëri
gjithçka duket gri,
nga mali mezi vjen zëri
i të palodhurit bari.
Nisin të parat flokë
të bien dalëngadalë
tek unë në dhomë bën ngrohtë
se kam ndezur një goxha zjarr.
E shikoj malin, të lartë,
malin krenar,
në sup ka hedhur rrobën e bardhë,
ndërsa flokët e buta
oborrin mbulojnë,
rrotull koçekut,
harabelat misër kërkojnë.
Mbi çati,
këngës ja merr arroganti gjel.
Ai s'do t'ja dijë për dëborën
Se pa misër nuk ngel.
Çobani gjithë shend e verë, tufës i pri
Në dorë mban qengjin, fytyra i ndrin
lindje të mbara ky vit do t'i bij.

TOKË E DJEGUR

Çfarë paska kaluar nëpër këtë tokë
gjithçka shkatërruar,lëvizur gjithçka,
dhe gurët pemët,djegur i tërë pylli
s'paska një degë ku të këndoi bilbili.
Shikoj e syve s'u zë besë
më kot kërkoj një shkak,
më kot kërkoj një ndjesë.
Mbi dhe paskan mbjellë kobin
e paskan fyer njeriun dhe Zotin.
Rri e mendoj ulur mbi kodër
aty ku pisha mbollëm dikur,
dhe pyll të bukur krijuam
nuk di përse zjarrin i vunë?!

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

U N Ë VDES

Unë vdes pa e njohur,
pa e njohur qoftë,
qoftë edhe një çast
miqësinë e sinqertë,
ëmbëlsinë e jetës pa e shijuar!
Turbullohem,
Turbullohem në vetvete
në iluzione të kota
të kota si vetë falsiteti
që na dhuron bota.
Turbullohem .Po. Po.
Turbullohem në ngjyrat e shpëlara
që jeta na servir përpara
si një pjatë me garnitura të tharta.
Akulli ka nisur
nga lumenjtë të shkrijë,
ndoshta pranvera
të vijë nuk është larg...
po shkrihet, po shkrihet, pak nga pak
pranvera ka trokitur në prag.
Por në zemrat tona, ndoshta
ky akull do të qëndroi gjatë,
Atje lart në qiell, dielli
i vogël sa një pare serme,
acar lëshon mbi ne mes reve.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

BARIU

Pranvera vjen dalëngadalë
Çelin lulet e vendi jeshilon;
Bora zbardh veç lart në male
Bariu tufën në kullotë e lëshon.
Fyellin në brez kërrabën në dorë
I prin tufës prryj,prryj ej,ej
Në gem këngës ja ka marrë bilbili
Erdhi pranvera u ringjallë pylli.
Përkëdhel era gonxhet e trëndafilit
Që aromën përhapin në ajri,
Përzihen blegërimat
me këngën e bilbilit.
E bukur,e bukur kjo simfoni,
Kuku qyqja në degë të thate të lisit
Të shkretën s'e zënë vendi në vend,
Ndërsa brumbulli në majë të plisit
Nuk donë t'ja di për askënd.
Blegërima e një deleje
dëgjohet nga larg
I vjen rreth bariut,e shikon e nuhat;
Kërkon qengjin e nuk zënë vend
Herë afrohet, herë shkon larg.
Më kot bariu mundohet ta qetësoi
I zgjat dorën me misër,
por ajo nuk pranon
Blegërin pa pushim
blegërin dhe loton.
Në shpirt i therë bariut
kur lot i shikon.
Oh! Të shtatin ja thera: falmë zot!

2

Tre ditë pa pushuar qau e mjera
Tre ditë nuk vuri gjë në gojë,
Kërkonte në lëndinë e ferra
Por zërin e qengjit nuk e dëgjoi.

Të katërtën ditë bariu kur u zgjua

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Zërin e deles më nuk e dëgjoi,
Ishte herët ende ndriste ylli
U nis bariu tufën të lëshoi.
Si gurë i ngrirë me shikim nga qielli
Qëndronte delja; të ngrihej s'dëgjoi
Bariu lotin s'e mbajti i mjeri,
Një dhimbje në gjoks e shtrëngoi.
Me dele kaluar kishte një jetë
Thoshte se mirë ua njihte çdo sekret;
Por ashtu si jeta
dhe zanati s'paska kufi
kështu s'kishte parë e dëgjuar vetë.
Shikon rreth e qark me imtësi
hudhra dhe patkoi varur tek dera.
Këtu jo nuk ka magji
Jeta na nxjerr sekrete të tjera.

Jo, jo, magji nuk është kjo,
Po në tufë ç'më ka ndodhur vallë
Ah, moj jetë sa gjëra na mëso
Gjëra, që s'i dinim më më parë;
I lëshoi dele dhe u dha kullotën
Të sëmurën e nxori tek lisi.
Mori kazmën të hapi gropën
Siç bënte ndjesë pastë gjyshi,
Nuk deshi doktorin ta thërrasë
Se shpesh i ishte lëvduar.
E njoh delen unë ore kokë dërrasë
mulliri yt e nxjerr grurin pa bluar,
Por rrugëdalje nuk pati sot
Veç ai që s'di mburret në këtë botë
S'e e mençuri s'fle kurrë kot
Para doktorit sytë iu mbushën me lot.
II
U nisën të dy hipur mbi kalë
Në shpirt bariu ndihesh i vrarë;
Pylli kish marrë një pamje mortore
Qyqja në degë të thate vajit ja thoshte.

Dhe zbritën nga kuajt fluturim
Drejtë vathës nxituan kot,
Ajo tani nuk merrte më frymë
Veç nga sytë i pikonin lot.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Kur e pa doktori
habinë s'e fshehu dot
Kafsha e pajete si mund të nxjerri lot?
Të bëjmë autopsinë të shohim
ç'të jetë vallë?
Një rast si ky kurrë nuk kam parë
Doktori nisi nga puna,
pyetje i bëri shumë
Më thuaj kur është sëmurë
Raste të tjera a ke pasur?
Thinjat më dolën në këtë punë
Por kështu s'kam hasur
Jo, nuk ishte e sëmurë,
Dhe raste të tjera s'kam pasur
Por i thera qengjin të shtatin.
Të mjerës zemra do t'i ketë plasur
I tha bariu më kokë lëshuar në tokë
Kështu thotë ajo jotja
Që kujton se din' shumë,
Por çfarë ka pasur kjo e gjora
Tani të ta them unë.

I tha doktori dhe vazhdoi i qetë
Por kur zemrën i hapi,
Flokët iu ngritën përpjetë
Dhe mornica iu mbush i tërë shtati.
Bah! ç'po shikoj,
ndoshta paske të drejtë
Shtatë gropa në zemër i paska vërtetë.

Bariu e fërkonte si të ishte gjallë
Buza iu dridh;
dhe s'duroi pa qarë.
Po ti hesht mos qaj o i zi
Të ka ngordhur një dele;
nuk është njeri
Nuk është ashtu,jo, doktor
ndjenja ka dhe kjo e gjorë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

DURIMI YNË

Shkarpat e durimit,
Në zemrat tona nxehen pa pra
Nxehen e nxehen,
një ditë në flakë me u kall.
Kur urrejtja ka me na përla
E në zemrat tona
të shpërthejë vullkan
Shkrumb do të bëjë
ç'farë përpara t'i dalë.
Zemrat tona,
Strehë durimi dhe falje
Në shtegtimet e jetës
kanë mbetur shituar,
Nga qielli presim veç borë e shi
Shpresën dhe gëzimin
Në vete do ta gjesh NJERI.
Zemrat tona të lodhura nga moti
Çdo ditë ,
më të gjëra bëhen për drejtësi
Por mos ardhtë dita,të fryhen nga inati
Se më s'do të njohin as Zot as njeri.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

MBULUR NË VUAJTJET E MIA

Mbyllur në vuajtjen time memece
Rënkimet të mos m'i dëgjoi askush.
Kënga, melodi e hershme
Zemrën ma djeg si prush.
Vështroj fshatin tim të vjetër
Ku mësova të flas e të ec,
Ashtu siç është
nuk e ndërroj me tjetër.
Të kthehem prapë, mezi pres
Shikoj lart nga mali
Hijen që zbret ngadalë
Atje në shpat çobani,
me fyell ja ka marrë.
O fshati im i bukur,
o fshati im vocërrak
T'i dua mal dhe kodër, të dua çdo prag,
Në rrugë dy gjela,
kanë dalë në mejdan.
Kacafyten gjithë mëri
Shoku- shokut s'i jep derman
Dhe tokë e qiell të bëhen një
Dhe them me vete,
them me gjithë shpirt
Kjo botë kaq e keqe kështu pse u bë!
Në paqe jetonim një ditë
(Sot veç grindje e luftë ka).

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

NË MUNDËSH

Në mundësh një ditë,
të ngjitesh në majën e Tomorrit,
Të ulesh në çerdhen e zotave
Ndalu aty tek burimi i ftohtë
Dhe pi ujë më grushte.
Si gjyshërit tonë dikur
Në mundësh një ditë,
Atje lart
në majë të bjeshkëve të ngjitesh.
Freskohu me ujin e ftohtë
Si rrugëtari,pas një rruge të gjatë
Në mundësh një ditë
Të ngjitesh tek Liqeni i Zanave
Apo Kroi i Dragoit
Atje ku Zotat kanë shtëpinë.
Tek gurra e ftohtë në hijen e ahut
Ku barinjtë tufën mrizojnë
E këngës ja marrin majë krahut
Dhe atje,
Në të zëntë nata
Në majë
të Tomorrit, Korabit a Jezercës.
Shiko në të katër anët e horizontit
Atje ku i thonë Shqipëri
Atje ku hëna me rrezet e argjendta
Shpon kreshtat e pishave
Dhe lëndinat ndriçon
Ndalu dhe priti Zanat
E me to vallëzo.
Vallëzo krah për krah me Zanat
Dhe po të erdhi gjumi,
Si në mëndafsh
në prehrin e Zanës mbështetu.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Mbështetu
dhe prit aty freskun e agut,
Që si një pupël
Lehtë të të fërkoi trupin tënd.
Prite aty lindjen e diellit dhe thuaj
Të falem o Perëndi!
Që më linde në Shqipëri.
Të falem! Dhe ulu e puth tokën.
Tokën e zezë puthe...

MOS E THUAJ NJË FJALË

Mos e thuaj një fjalë
në se ajo nuk hyn në zemra
dhe shëron plagë.
Mos e thuaj një fjalë
në se ajo nuk kthehet në polen
që do të pllenoi miliona lule,
lule që do të lidhin kokrra.
Mos e thuaj një fjalë
në se ajo nuk i ngjan
fëshfërimës së erës
në fletët e trëndafilit.
Mos e thuaj një fjalë
në se ajo nuk mbart me vete
melodinë e fyellit
dhe aromën e luleve të prillit.
Mos e thuaj një fjalë
në se ajo nuk është një kalli
i kërrusur në arë.
Dhe të lutem, o njeri
mos e thuaj një fjalë
në se ajo do të vrasi një dashuri.
Thuaj një fjalë
 në se ajo do të bëjë armikun
 të pendohet dhe
 të dëshpëruarin të gëzohet.

PO TË MOS ISHIN …..

Po të mos ishte xhelozia,
Dashuria do të ishte e pastër
Dhe do të ishte e përjetshme;
Po të mos ishte urrejtja
Vëllazërimi do të lulëzonte çdo ditë
frytet e tij do të mbushnin planetë
Po të mos ishte smira
Nuk do të ishte uni,
Dhe të gjithë
do të kishim më shumë
dashuri,
gëzim
e lumturi.
Po të mos ishte uni,
Nuk do të kishim luftëra,
Dhe njerëzit
nuk do të vriteshin
Sikur të kishin
shtatë jetë.
Po të mos ishte pangopësia
Njerëzit
do të qeshnin më shumë,
Dhe sëmundje do të kishte më pak.

MUNDET

Mundet që një ditë të kthehem
Një ditë. Po. Po. Një ditë
Mund të kthehem
Dhe e dini?
Aty bashkë me ju do të kullosim delet
Po u ktheva, gjithmonë, po u ktheva,
në kopsht do të mbjell qepë.
Po u ktheva, pra, në u kthefsha
Do të këndojmë këngën majë krahut
Si atëherë
kur mrizonim në hije të ahut
atje në mal,
ku peng kam lënë zemrën
sepse, ai s'rri dot pa mua
dhe unë pa atë emër.
Po u ktheva,
Tek varret do të mbjellim
trëndafila dhe qiparisa
që edhe ata
të kenë një lulishte
për të pushuar.
Po u ktheva, pra, po u ktheva
Zogjtë nuk do t'i vrasim më,
Se kjo botë ka nevojë për ata
dhe këngën e tyre .

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

MOS DËGJO

Mos dëgjo zërat e çjerrë
Që si zogj ndjellazi
Kërkojnë që të të frikësojnë.
E as ata,
Që lëvdata të thurin në sy,
Se pas shpine nesër të qëllojnë.
Sonte
Mbushe gotën me verën më të mirë
Në tavolinën e zbukuruar si për festë
Ulu e pi.
Pi sonte, në këtë natë të gjatë.
Në u dehësh, shtriu e fli
Si atëherë kur ishim të dy.
Është natë.
Jashtë bën ftohtë.
Në xham era përplaset.
Bëhet një mijë copë
Unë këtu pi verë e raki
De në shpirtin tim
akulli s'ka për t'u shkri…..
Por ti,
pritëm.
Pritëm. Dhe në mos ardhsha
Të lutem,
Njëlloj
Ulu e pi,
Se shpirti im do të jetë aty.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

POETI

Në studion e tij të ngrohtë
Nga dritarja
Shikon qiellin gri.
Harabelat
Ngutshëm fluturojnë...
Kush shokut ushqimin t'ja marrë
Në shpejtësi
Poeti hesht.
Me dorën mbështetur në ballë
Me sy gjysmë të mbyllur
Mendon dhe thotë
"Dhe tek këto,
si në mbretërinë tonë
I fortë "uni" sundon.
Në studion e ngrohtë,
poeti don të zbuloi;
LUFTËN. Njeriu e mësoi
nga kafshët, apo atyre ua mësoi ?

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

KUR ISHIM FËMIJË

Ndiqnim pilivesat kur ishim fëmijë
Duke i rënë rrotull avllisë.
Ah, sa gëzoheshim
kur gjenim një furrik
Në gëmushën pas shtëpisë!
Ua zinim rrugën milingonave
Me njëmijë prita
Por ata e hapnin prapë
Sa zbardhte dita.
Ngrinim rrasa e laqe
Kur ishim fëmijë;
Sa hidhëroheshim
Kur në vend të zogut,
Gjenim një mi.
Ëndërronim një ditë
Të bëheshim burra;
Në xhep orën me qystek
Krahun të na e zbukuronte pushka.
Shkonim për të zënë peshk në lumë
Sa shumë gjarpërinj gjenim atje
I vrisnim me gurë dhe,
Me kunj ua zhysnim kokën ne dhe'
por për çudi,
të nesërmen më shumë gjenim atje.
Laheshim në hurdha të mëdha
dhe mbi rrasa shtriheshim lakuriq
me sy të mbyllur si një pasha
në haremin e tij rrethuar nga miq. . Tani
që thinjat kemi në kokë
Na merr malli për atë ditë
Të ktheheshim prapë në atë kohë
mënjanë do i linim prapsit
MIK
…Dhe ti më thua mik?!
Dorën e djathtë ma zgjat
Timen shtrëngon me ngrohtësi.
Por mua ajo dorë
Si një copë akulli më rri

që kurrë nuk do të shkrijë.
Rrobën ma bën në trup
si një gjë të pështirë
që më jep neveri.
Në të majtën ti mban një thikë
Me helm ngjyer
Më fërkon në shpinë,
Për të parë
Ku;
Të ma ngulësh më mirë.
…Dhe ti më thua mik
Më fton edhe për kafe.
Nga shikimi im ke frikë.
U zverdhe sapo më pe.
…Dhe ti më thua mik

Po. Po. Dikur ishim edhe shokë
Por sytë e vërtetë t'i pashë;
Atë ditë,
Kur më shtrive për tokë.
Sytë të xixëlluan, oh mik, o shok
Dhe fytyra t'u zgërdhesh
Kur gjaku më shpërtheu
Dhe skuqi për rreth
Të zezën tokë.
Nuk është dhe faji yt
Pse u bëre gjakatar
Ndoshta s'u bëre,
por lindur kishe kohë më parë.
Në cilat porta trokasim
Buzëqeshjen, kujt t'ja falim
I quajmë miq
Vrastar na dalin.

KALORËSI

Kalorësi hipur mbi kalë
Shtatin bajrak,
Si borë kësula mbi ballë
Në dorë flamuri si gjak.
Kali sa nuk fluturon
Nga goja nxjerr shkumë;
Dhe frerin bren me dhëmbë
Trokëllin, hingëllon më shumë,
në oborr të kullës kur ndalon
kalorësit mbi kalë
gjaku nga goja i kullon
hingëllin ky kalë
duket se ndihmë kërkon
për kalorësin e vrarë.

NË GALERI

Jashtë bën ftohtë, bien edhe shi
Pemët si vajza të turpëruara
Zhvishen një nga nji.
Ne këtu jemi ngrohtë,jemi në galeri
Çadrat në plazh mbushur me të rinj.
Një tjetër tela, bahçe me trëndafila
Në një tjetër, dy të rinj
kullosin dele dhe qengja.
Këtu bën ngrohtë, bën ngrohtë
Jashtë bie shi, jashtë bën ftohtë,
Drurët në rrugë zhvishen një nga një,
Një i moshuar me këpucë të çara.
Me xhaketën me arna një mijë
Mbështetur në murin e kishës
Dremit dhe pse bën ftohtë e bie shi.
Dorën mban të shtrirë
Pranë këmbëve një tas a një sini,
Brenda bën ngrohtë
Ne vizitojmë në qetësi.
Dikush thotë"E shikoni atë plazh?
Parajsa mbi tokë është aty

Kam qenë aty, me fëmijët e mi.
Më të bukur vend s'kam parë me sy"
Këtu bën ngrohtë, jashtë bie shi
Plaku mbështetur në mur
Gjatë do të më rrijë në sy.

KAM DËSHIRË SONTE

Kam dëshirë ta shoh qiellin
që mbyllet dalëngadalë,
dhe flokët që nisin të bien
Si një vello e bardhë.
Harabelat në oborr që vend nuk zënë.
E sillen rreth kotecit,
çukasin në çdo anë
Në gëmushë mëllenja këndo,
Humusin shpupurish me nxitim.
Ndonjë farë, insekt apo krimb kërko
Tymin që del me vrull nga oxhaqet,
Llërë përveshur e duart me brumë
Amviset kur gatuajnë në magje.
Të dëgjoj erën e bukës së ardhur
Që piqet në furrë,
Erën e barit të tharë
Kur nga mullari hiqet palë, palë.
Në krah kur e marrim, dhe
bagëtisë ja çojmë në stallë
Kam dëshirë të dëgjoj
Erën e tokës së pluguar,
Të shikoj turmat e zogjve
Pas plugut duke vrapuar.
Të shikoj bimën e sapoçelur
Që rritet me shpejtësi
Mbi gjethe tek mban
Farën nga ku ka mbi'.

Të shikoj qengjin zevzek,
Që shkon të pijë një tjetër nënë
Delen që nga pas e nuhat
Dhe e shtynë për ta përzënë.
Kam dëshirë të shikoj
Zogun tek çan
Dhe del nga lëvozhga,
Zogjtë që vrapojnë
sapo i thërret klloçka.
Kam dëshirë të shikoj
Të xhevahirtën vesë

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Mbi fije të barit, apo nga
domatja e kuqe të zbresë.
Të ndiej erën e ëmbël të misrit
Kur nis e nxjerrë xhufkë
Apo të ulem në hije të lisit
Të pi një matara qumësht.
Të ndiej erën e rrushit që nxin në degë
Të shikoj mollën e ëmbël,
Dhe faqekuqen shegë.
Diku atje tek del një tym
Flitet me zë të lartë,
E këndohet me çifteli
Atje të shkoj ku bëhet raki;
Të ulëm pranë kazanit verë musht të pi
I bukuri fshati im, i bukuri ti
Atje gjallon jeta, atje ka mirësi.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

ÇFARË KA NDODHUR ME VENDIN TIM

Grindu zemra ime, shfryju pa pushim
Për lumturinë që nuk e pate kurrë,
Në se nesër më nuk do të rrahësh
Merak mos kij, se në lëmshin tënd
Halle, më nuk kanë për t'u thurë
Ikur paskan të gjithë!
Dhe s'dihet se ku,
Dhe nuk dihet se kurë,
Ndoshta dekada kanë kaluar
Ndoshta!…
As zogjtë nuk cicëruakan
Në shkurre nuk këndon mëllenja,
Veç në degë të lisit
Vajton qyqe-mjera.
Oh, çfarë mynxyre!
Po ku vallë janë njerëzit e mirë
Zilet e këmborët, qengjat e kecat
Ku janë?
Mollët e qershitë,ftonjtë ,
pse nuk lulëzojnë?
Djemtë e vajzat e fshatit
Pse nuk lozin e këndojnë?
Vajta të pyes fikun varradac
Vajta të pyes atë fikun plak
Si një dëshmitarë i harruar,
me degë të tharë e rrënjë të dalë.
Oh, Perëndi! Vetëm fiku, vetëm ai,
dëshmi e tokës sime
trashëgim i punës,
trashëgim i lodhjes
së të parëve të mi,
vetëm ai,
më shumë degë të thata
se gjethe të njoma. Vetëm ai…
vuan në tokën e tij
aty ku e ngulën
aty ku s'dihet sa kokrra ka lidhur
sa kokrra ka pjekur,
sa njerëz në ata degë kanë hipur
aty pret

që një ditë prapë të vijnë.
Pleh në rrënjë t'i hedhin
degët e thata t'ja presin
ndoshta pret,
që djemtë që e kanë braktisur
fshatit t'i kthehen
e ai
prapë të gjallojë.
U ndala, vështrimin hodha qark
Kudo gurë e ferra e në mes.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

POROSI

Dashurohu,
në fjalën e lirë e të drejtë,
në nderin e himnit e të flamurit
në aromën e tokës së punuar
Në erën e barit të korrur
Aty, ku sythe çel gruri.
Ngreje kokën drejtë qiellit
Në çastin e lindjes së diellit
Dhe të perëndimit të hënës
Atëherë, kur ndrin më shumë ylli
Dhe mbaje,
Amanetin e nënës.
Ndalu tek kroi, ulu e pi
Freskohu në ujin e gurrës
Dhe thuaj
Të falem o Perëndi
Që më linden në Shqipëri.
Në tokën e gjyshit,
Aty ,dashurohu ti.
Dashurohu
Në belbëzimin e fëmijës në djep
Në cicërimën e zogut në çerdhe
Kur nëna ushqim i hedh në sqep
Dashurohu
Në erën e mushtit të rrushit
Në këngën e gjelit mbi pullaz
Në ngrohtësinë e prushit
Dhe buzët e vajzës plot gaz
Mos u dashur...!
Në sytë e bukur të një vajze
Në se ata u ngjajnë syve të panterës
As në buzët e gjuhën e hollë të saj
Në se ata janë me helm
Si ata të nepërkës
Mos u dashuro
Tek një vajzë
faqet si mollë e sytë ulli,

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Por në shpirtin e saj mëndafsh
E buzëqeshjen si fëmijë.
Mos u dashur
Në britmat e çjerra të natës,
As në klithmat e zogut ndjellakeq
As në kohën e humbur kot
Se e djeshmja nuk vjen sot.

Mos harro zërin e ëmbël të nënës,
Dhe ngrohtësinë e diellit të vendit tënd
Se për ata nevojë do të kesh
Çdo mbrëmje e mëngjes.
Mos rend
Pas fjalës ledhatare,
Si bleta,kur polenin në lule mbledh
Kujdes!se në polenin e asaj fjale
Dhe helm mund të gjesh.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

PËRSHËNDETJE MIRDITORE

Shumë jetë bashkë
Dhe zemrën hedh në sofër
Të pastër si rrezja,
të gjerë si horizonti
Bujari mirditori.
Shumë jetë bashkë
E ëmbël buzëqeshja e cucës
Me faqet si hëna
Dhe sytë porsi ylli
Hapin të lehtë
Si fëshfërima e erës.
Të ëmbël e ka e fjalën,
Ai burrë i besës
Për mikun që si mik
I mësyn drejtë derës
Si bilbili kur këndo majë degës.
Çiltërsia e tij-ëmbëlsia e jetës
si belbëzimi i fëmijës
simboli i shpresës,
por nuk është ashtu gjithmonë
në i prekësh në besë, nderë e shtëpi
më mirë vetes, varrin hapja ti
dhe i gjallë vetë futu aty,
se zemra kristal,në strall i kthehet atij
që do të djegë zot e njeri.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

ZOTI FLET ME VETEN

Para pasqyrës këmbëkryq rrin Zoti
I plotë fuqishëm e madhështor,
Veten shikon siç bënte qëmoti
Fytyrën përqesh, pështynë dhe thotë:
Ti mburravec megaloman
Që botën krijove tërë bukuri
Thua se krijove shëmbëllesën tënde
Dhe emrin ja vure njeri.
Haha, haha, haha, si nuk u gdhende
Phu, phu, phuu, turp për ty!
Krijove atë që nuk ka besë e gjak,
Që gurit dhe drurit i ka hyrë në hak
Për dy lekë fëmijën prano ta shesësh
E përdhuno, pa dalë nga djepi.

Phuuuu, phuuu, phuuu!
Kot mburresh more plakush,
E betohesh se do të bësh çudi
Se mbi mëkatarët do lëshosh prush
Se i pari mëkatar je vetë ti.
Phu, phu, prapë nis e pështy.
Kot e ke more mburravec,
Se i drejtë s'ke qenë asnjëherë
Që kur krijove njeriun- mistrec
E të mori faqe e nder.
Jo, jo, nuk je askush

Ndoshta edhe nuk ke qenë asnjëherë
Kot thua se kupa ende nuk u mbush
Se edhe ty ajo do të zërë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

JETO

Jetoje, moj jetën tënde,
Dhe timen shqelmoje pa frikë
Eja të ngremë një dolli sonte
Dhe të pimë deri në të gdhirë.
Të pimë dhe të këndojmë
Dhe në qoftë e fundit kjo natë
Ti nesër ngjitu në majë
Unë le të bij në gjumin e gjatë.
Hajde moj, kot jetën mos e ço
Se ajo po iku, më nuk të kërkon
Mos mendo për të tjerë
Gëzoju gotës me verë.
Gëzoju qiellit me yje shumë;
Nesër prapë gëzoju
Edhe po nuk qeshë unë
Le të jetë si të doje dita nesër
Jetoje te sotmen, jetoje ti
Po qe se nuk kam fjetur
Eja të pimë përsëri.
Diçka më ndrydhë në zemër
Dhe buza m'u dridh kaq shumë
Një yll u shkëput nga qielli
Dhe dritën e hënës retë e zunë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

NUK E VRET DOT

Në se e vrave bilbilin
Këngën nuk ja vrave dot.
Atë e këndojnë pishat
Fushat,
Lisat;
E këndojnë fëmijët
Se kënga shtatin ua rrit.
Atë e këndojnë mërizat
Ku ëmbël blegërin ogiçi
E kënduan trimat
Kur zëri atdheut t'i thirri;
Në se i këput gonxhe
Mos u kënaq kot
Aroma u është përhapur
dhe zemrat i ka rrokur.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

FTOHTË

Si pa kuptuar u ftoh koha
Era loz me gjethet që bien.
Si tapet duket toka
Po zhvishen të shkretat pemë.
Zemra ime ndjen dimrin
Që po vjen tek porta,
Një copë akull në shpirt më hyn
Pritmëni mua o gjethe të verdha
Pritmëni, tokës t'i bëjmë shoqëri.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

LOZ MOJ ERË

Loz moj erë me gjethet
Si jeta me fatin tim.
Lozni, mor lozni
se një ditë,
ndoshta, larg nuk do të jetë
me veten ke për të lozur
gjersa nga koka
tymi do të dalë përpjetë.
Loz moj erë me mua
përplasëm nga të duash
ashtu si jeta e tërbuar,
se një ditë,
ndoshta larg nuk do të jetë
ke për t'u penduar
dhe nuk do të pranoi askush
e ti s'do të jesh e qetë.
Lozni , moj lozni ti edhe jeta
mos më mëshironi
se një ditë,
ndoshta larg nuk do të jetë
kur unë dhe gjethet të mos jemi
dhe tymi të mbulojë retë;
ju prapë do të jeni
por asnjëra pa ne
vlerë nuk do të keni.
Loz more fat me mua

Si macja kur loz me miun
Ku të mundesh me më kafshuar
Mëshirë spate për njeriun.
Loz se një ditë,
Ndoshta larg s'do të jetë
Ti fat i tërbuar
Do të lozësh me erën dhe retë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

KËRKOJ NJË TUFË ME LULE

Kërkoj një tufë më lule
Parlamentit t'ja vë në derë.
Të qëndroj kokulur dhe të hesht,
Në fund të them: Erdha sot,
por ti, kishe vdekur ka herë.
Një tufë lule kuq si gjaku kërkoj
T'i mbledh e t'i thur me kujdes
Para portës së tij t'ja çoj
T'i them: aferim o sulltani mbret
T'ja lë aty dhe të shkoj.
Një tufë me lule të vyshkura kërkoj
T'i bëj kurorë, mezi pres,
Se të vyshkura i pat fjalët opozita
Që kur lindi derisa u shtri të vdesë.
Të qëndroj aty, të qëndroj shumë
Dhimbje do të ndjej me siguri
Vodhën dhe nuk kryen punë
E bënë vendin lesh e li'
O njerëz të mirë, hapni ata sy!
Kërkoj një tufë lule kuq si gjaku
T'i mbledh e të bëj kurorë
T'ja çoj sot, po sulltanit mbret
T'i them me zemër në dorë
I kuq do ngelesh edhe në atë jetë….

Mos ke merak, mos kij, bre burrë
Të presin tokë dy metra dhe dy gurë
Gajle mos kij, sulltani mbret
I kuq do të jesh dhe në atë jetë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

NIKËS

...Nika ka vjedh!
Fjala
Ka dalë nga buza
Dhe ka marrë dhenë.
U përhap
Si era e qelbur
E një çakalli të ngordhur;
Gojë më gojë,
Nën zë
E mbi zë.
Mark-o, e more vesh?!
Çfarë?
Nika ka vjedh!
Jooo!
Mos e thuaj të shitoftë!
E tha ai.
Kush he e vraftë…
Sekretari.
Kur, more?
E vraftë i madhi.
Paj unë nuk isha
Nuk isha e mos qofsha!
Bah, sa keq!
Të gjithëve
Po na turpëron !
Përhapet fjala
Si erë e qelbur
E një kërme.
Fytyrat e ngrira të shokëve
Nxijnë.
Frika si një perde e zezë
E akullt bulon
Buzëqeshjet e tyre,
që si petalet e fishkura
Të një lule,
Këputen
Bien për tokë.
Nuk qeshin.
Nuk gëzojnë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Jooooo kurrë!
Nuk e besojnë.
“E kanë ngatërruar”
“Pasha diellin,
Më sa kam prek unë”.
“Pasha qiellin
Në zjarr i vej duart”.
“Pasha të lumin
Nuk është e vërtetë”!
Dhe ndoshta
Të gjithë e ndjejnë
Se herët a vonë
Në shtëpi s’do flenë.
Ashtu kot,
Siç morën Nikën,
Për një sqarim
Një sqarim
Do të marrin
Dhe të tjerët
E akulli në zemër
që trashet
mbi supet e tyre
peshon
si dërrasë varri.
Fjala ka dalë
Ka dalë e askush
Nuk do ta besojë.
Nuk do
Por kjo nuk ka rëndësi.
Nika atje
po kalbet
në hetuesi
dhe po ta ngjitën damkën
zjarri të ka përpi.
prano apo mos prano
kjo s’ka rëndësi.
Nika dridhetnë hetuesi
Maria me fëmijë
në shtëpi.

Kur e morën Nikën
Atje në parcelë
Një pyetje ai bëri

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Po qetë në stallë
Kush do t'mi shpjerë?
Mendon partia
Merak mos kij
Ne ecim përpara
Kriminel më mirë
Pa ty,
E morën Nikën tek punonte në arë
E çuan atje për një sqarim.
Ishin n zyrë;
kryetari e shoku "komisar"
Fol hapur, i thanë
trego shokët,tradhtar
bashkëpunëtorët tuaj në sabotim.
Partia i din të gjitha;
Dhe atë që ti nuk di
Dhe atë që ti s'e mendon
Mos u mundo,
Se neve nuk na shpëton
Është e fortë partia
Mor gjarpër i zi.

Era ia tundte xhaketën e grisur
Ai nuk ndalej as në diell as shi
Zemra copëtuar. Shpirti maisur
Për atë njollë që kishte në biografi.
Kjo kishte ndodhur kohë më parë
Në dritë Nika ende s'kishte dalë
daja i tij qe shpallur tradhtar;
(Pse qe i pasur,
dhe shumë punonte në arë).

Dhe shiu binte përzier me borë
Era frynte me furi
Një copë bukë e mbante në dorë
Thatë e hante, se kishte uri.
(Tre qerre në ditë nga njëzet kuintalë
Duhej t'i çonte tek lopët në stallë)
Të realizohet plani
Në acar, vapë, në diell a shi
Këtë kërko nëna parti.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Era i tundte xhaketën e grisur
Të grisur si fati i tij,
Por në punë dilte pa gdhirë
Dhe vetëm natën kthehej në shtëpi.
E donin shokët Nikën
Edhe pse kishte atë biografi
I pasur paskësh qenë
Ndjesë pastë gjyshi i tij.

Atë vit nuk qe realizuar planin
Tërmeti do të binte në brigadë
I njomë do digjej bari
Në vend të barit të thatë.
Armiku kishte vepruar
Por edhe në se jo
Kjo duhet pranuar,
Ai në fshehtësi vepron
Të kërkohet armiku
Te kërkohet kudo.
Të gjithë e dinë
Se dhe në mos qoftë
Partia diku, e zbulo.

S'u prodhua gruri
S'u bë as misëri
Deficit patëm
Tek qumështi dhe mishi.
Partia toruan s'e humbi
Nuk iu dridh qerpiku
Furtuna s'e tundi
Më te fortë bëhemi
Kur zbulojmë armikun

E morën Nikën tek punonte në arë
E çuan atje për një sqarim.
Ishin n zyrë;
kryetari e shoku "komisar"
Fol hapur, i thanë
trego shokët,tradhtar
bashkëpunëtorët tuaj në sabotim.
Partia i din të gjitha;
Dhe atë që ti nuk di
Dhe atë që ti s'e mendon

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Mos u mundo,
Se neve nuk na shpëton
Është e fortë partia
Mor gjarpër i zi.

Era tundte xhaketën e grisur
Dhe s'ndalej nga puna ai,
Zemra nga dhimbja maisur
Por puna mbrapa s'duhet të qaj.
Makina gati fluturonte
Nëpër rrugën me gropa e llucë
Jashtë shiu dhe acari të shponte
I lidhur Nika shkonte në birucë
Merak do të bëhet Maria
Dhe gjumë nuk ka për të fjetur
Do të qajnë fëmija
Si zogj të trembur
Lekë për bukë
Për nesër nuk ka
Ndoshta më lirojnë,
Ndoshta merr hua
Natë.
Errësirë dhe tufan.
Era breshrin e përplas në xham
Në qiell vetëtimat flakërojnë

I lidhur, Nika me pranga shtrënguar
Xhaketën e grisur, çizmen e shpuar
Tani do të shikosh more tradhtar
Që minat i vure pushtetit popullor.

Zjarri në sobë mekej ngadalë
Maries ankthi i bëhej mal
Era frynë, frynë, pa pushim
Çdo gjë në akull është kall.

Ajo në zemër ndjen një drithërim
Ku është, pse u vonua, pse vallë
Ndoshta në mbledhje janë deri vonë
Se fundi i vitit është tani
Për planin duhet të diskutojnë
Bëjnë dhe planin e vitit të ri.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Era përplasej në dritaren
Mbyllur me plastmas
Erën të priste
Dritarja nuk kishte xham
Maria
shtatzënë dhe një fëmijë në gji
 Për Nikën në birucë
Partia kishte vendosur
Që ai të jepte llogari.

Zjarri në vatër shuhej pak nga pak
Së shpejti aty do të mbetej veç hi
Rrinte në këmbë me duar në bark
Rrinte Maria se kishte merak
Si do rriste vetëm pa baba tre fëmijë.
Nga na zuri ky kob, kjo myënxyrë
Lotët si shi, i rridhnin në fytyrë
Tjetër gjë Nika nuk ka ditur
Veç të dalë në punë, që pa gdhirë.
Nuk ka njohur diell, s'ka njohur shi.
As vapë e acar as lodhje dhe uri
Çdo ditë ka bërë, norma nga dy
Se do ushqente gruan me tre fëmijë.

Shoku Zef dinte ç'të bënte
Kishte thirrur në prokurori
Ata që mendja ia thoshte
dhe do të thoshin çfarë donte ai.

Thirrur kishte edhe doktorin
Eja ti djalë fol çfarë ke parë
mos e mbro kot sabotatorin
fjala jote e çon në litar.

Prej tej duam vetëm një fjalë
Nga qelia ai të mos dalë i gjallë.

Doktori hesht, gjë nuk ka parë
Nika është më i miri djalë
Një fjalë do ta thuash se s'bën
Partia sot, kërkon kurban.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Shoku Zef, unë s'jam për këtë punë
Partia nuk ka nevojë për spiunë
S'e them atë që s'e di,
Për kurban gjej tjetër njeri

Po s'deshe qelinë dhe ti mor jezit.
Hap gojën, fol, lutje mos prit
Ndryshe të marr të pandehur dhe ty
Deficiti e ka një arsye.

Vidhte Nika, vidhte vërtetë
Një grusht me hime
A një kalli misër për qetë.
Për fëmijët dhe gruan
Veç norma gjashtëdhjetë
Vidhte Nika, vidhte,
por të tijët nuk ishin qetë.

Kau po nuk hëngri nuk vlen një grosh
qerren s'e tërheq
dhe të jetë sa një kosh
po u rrëzua një herë, është zor ta çosh
po të ngordhi,
burgun mund të provosh?!

Dhe Nika, ashtu me hekura në duar
Në një dhomë të mykur e hodhën
Si të ishte një thes me zhur
Faktet shpejtë e shpejtë i mblodhën.

Ditët plumb në qeli
Koha në vend kishte ngec
Nata e zezë si fati i tij
Jeta vuajtje, kripë dhe spec.

Në pyetje e merrnin pa orar
Nga gjoksi i shkulej zemra
Kur përpara i sillnin dëshmitar,
që në dorë mbanin ata letra
nga Zefi përgatitur më parë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Dridhej edhe dëshmitari
Dhe letra që mbante në dorë
Nuk donte ta lexonte i ngrati
Çfarë kishte shkruar prokurori.

Lexoje me kujdes thoshte Zefi
Mos harrosh ndonjë fjalë,
Për këtë është gati litari
Se me armikun ka lidhur kurorë
Ti nuk je i pari
Që ke këtë letër në dorë
Lexoje pa frikë, i thoshte Zefi
Ti je i yni, ky qen do të vdes.
Kokë ulur Nika dëgjonte
Ç'ka lexonte dëshmitari
E dinte mirë, se pastaj
mbi trup di t'i binte litari.
Lexonte letrën dëshmitari
Por shkrimi nuk ishte i tij
E kishte shkruar prokurori
Me kujdes e qetësi
Bravo, shumë mirë, djalosh
Partia kështu të do,
Për sonte mbaruam
I qetë mund të shkosh.
Dhe rri vigjilent,
Armikut mos i beso
Katër bëjë sytë
Porosinë mos e harro.
Dorën i vinte në shpatull
E prekte miqësisht,
Por ajo dorë kishte akull
Që e ngrinte përjetësisht.

Nika ngriti kokën
Shokun e pa kur doli
Në zemër mallkoi tokën
Dhe kohën që e polli.
Iu dhimb shoku Nikës
Një lëmsh iu mblodh në fyt
Sa poshtë paska ra
I shkreti, sa lirë u shit.
Dhoma bunker dridhet nga bubullimat

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

I vetëm aty qëndronte Nika
në duar pranga, në shpirt thika
ku njëlloj ishin nata dhe dita
Kokën në tokë lëshuar
Trupin gjithë plagë
Mendon në vetmi
Për natën e gjatë.
O Zot, ç'të bëra
me zë thërret
ç'kam bërë o Perëndi
që po më vret?!

Heshtje!
Në dhomat e tjera asgjë s'pipëtin
veç në korridore dëgjohen hapa
që gjakun ta ngrijnë.
Kërcet llozi dhe
hapet dera
brenda prapë shoku Zef,
hynë porsi era.
hape gojën këlysh
mos më mundo shumë
Tregoi shokët
Apo t'i them unë,
kush është i pari,
ty kush të ka fut
fol në se nuk do
atë kokën të ta këput.
Trego më mirë grupin
sa jeni, ku jeni
mos mendo mor qen
se Partisë ja hidhni;
shqiponjë ajo e ka syrin.
E kapi për krahu, në këmbë e ngriti
pistoletën nxori rrëzë veshit ja ngjit
litarin e lagur, më sillni, i tha policit
e bëj unë t'i hapet goja jezitit.

Xhaketën e grisur ia hoqi nga trupi
Flokët me forcë
me gjithë rrënjë ja shkuli
Nga dhimbja Nikës iu errën sytë
Gjunjët iu këputën ra si meit,

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Kur një bizë prokurori i nguli.
Kovën me ujë të ftohtë mori Zefi
të gjithën në trup ja hodhi dhe,
Hahahaha, i kënaqur qeshi
Shiko sa mirë qafir qenka
Prapë ia nguli bizën tek thembra
Hahhhhaaaaha qeshi Zefi
fresku djalë ta forcon shëndetin.

Dëgjo armik, dëgjomë me kujdes
Hape gojën, mos më rri si hu
Po nuk pranove, po më lodhe mua
Këtu do të kalben, kockat e tu
me armikun partia sillet kështu.
Nuk di ç'të pranoj, mezi foli Nika
me sy gjysmë mbyllur
trupi plot me thika
nga dhimbja dhe të ftohtit
dridhej siç dridhet fleta.

****

U mendove mirë ti bukurosh
ne çdo gjë dimë, ti duhet të pranosh
fol hapur. Shkoqitur ti trim
çfarë ke folur, për shokun Stalin!?
Paskeni vendosur shoku prokuror
mua këtu të më bëni kurban
hapeni kur të doni atë gropë -varr
bëjeni shpejt , çfarë keni në plan.
Për Stalinin asgjë nuk di
njoh gruan dhe fëmijët e mi,
njoh dy qetë që i dua shumë
nga fëmijët e mi si ndaj unë.

Me ankth e priti atë ditë Nika
gjyqi qe bërë kohë më parë
vendimin e kishte marrë, Partia
Të vihet shpejt armiku në litar.
Nga vdekja Nika nuk kishte frikë
vetëm mendonte për gruan e tij
atë ditë ngjante me një fëmijë
priste tek dera me fëmijë në gji.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Priti më kot, deri vonë
Kur në sallë s'kishte mbetur njeri
Nikën e nxorën nga tjetra anë
Të lidhur e sollën prapë në qeli.
Nga Partia kishte ardhur një letër
Ndaluni djema të mendojmë pak
Ndoshta duhet një tjetër akuzë
Më e ashpër, apo më e butë.
Stalinin ta lëmë
Marksin e Leninin
Akuza të lidhet me prodhimin.

Rëndonin ditët në shpirtin e Nikës
Jeta qëndronte e varur në pe
Shpirtin ja brente krimbi i frikës
Këto s'kanë as besë as fe.
Të fusin brenda, lidhur këmbë e duar
Sikur Zotin kë zënë me gur
Të rrahin, të rrjepin ,të lagin, të thajnë
Prano, thonë atë që bërë nuk ke
Që trupin nga koka mos ta ndajmë.

Kalonin ditët
Ngecnin netët
Ora rrotullimin e kishte harruar
Nika s'mendonte hiç për vete
Shpirti i digjej për fëmijët e gruan

Po fëmijët çfarë bëjnë?
Për të ngrënë a kanë?
Me dimrin e egër ,
vallë si ja bënë?
Po Maria, oh, i ziu unë!
Ku i le fëmijët
kur shkon në punë?
Shtatë vjeç më i madhi
tre muajsh i treti.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

O ç'më zuri halli,oh, ç'u bë kiameti
Mendonte Nika i mbyllur në qeli
Prapë dera kërcit "hajde çohu ti"
e kapën për krahu si një hedhurinë
pas pak do të numëronte,
dajakët në shpinë.

Kërciste dhembët dyllë, prokurori
Bukurosh, të shpëtova nga litari
Do të dënoj veç njëzet e pesë,
Të shkosh tek nxirret minerali
Bëj kujdes atje, se për besë
Ju gropos si minj kanali.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

URDHËR

Dikush dha një urdhër.
Të mbyllet Shën' Ndoi
Gurët i shkulën
Çdo gjë e rrafshoi
Por Shën Ndoi,
Ashtu,
siç ai s'e parashikoi
u hap në mijëra zemra
dhe përjetësisht qëndroi.
Dikush dha një urdhër.
Të digjet librari flora
Në qiell u ngrit tymi dhe flaka
Aq sa u zunë dielli e hëna,
Por librat ishin futur
Në zemrat tona,
Dhe askush
S'mund t'i nxirrte
As me gishta,as me ojna.

ALI OÇALAN

Të kanë lidhur gojë e sy
Të kanë lidhur këmbë e duar;
Por shpirtin s'ta lidhin kurrë
As fjalën s'ta ndalin bre burrë
Fjala jote:
Kushtrim,
Jehonë,
Fjala jote,
Rrufe në ditën me diell.
Për ata që
Popujt mbajnë në terr
Fjala jote,
Në zemrën e popullit
Rrënjë ka hedhur thellë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

LETËR NJOFTIMI

Vonë, shumë vonë e kam kuptuar
Se letër njoftimi edhe vlen, edhe nuk vlen;
Ma ka thënë këtë një plak moshuar
Që e pinte duhanin gjethe me gjethe.

Duhani, që të bëjë mirë, më tha një ditë
Duhet te jetë i pastër e i sertë,
Këtu duhet te jetë edhe burri, i zoti i tij
Dhe ta ndezë, me strall, çelik e eshkë.

Po i pate këto, nuk ka ç'të duhet ajo etër
Se burrat me një cigare duhan janë njohur;
Kanë zënë miqësi, e kanë lidhur besën
Letër njoftim besën e burrërinë kemi pasur.

Në aeroport po kaloja një ditë i vetëm
Pashë një që nuk pati me vete letër njoftim;
Por një zarf me ca dollar e një letër
Polici e përcolli deri në avion me nderim.

Por shpejt aty e ndalën një burrë të moshuar
Me dy valixhe e një çante në dorë,
Pasaporta ende nuk i pat skaduar
Pse qeëafër skadencës e kthyen burrin e gjorë.

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

VALIXHET E SHPRESAVE

I ngarkova valixhet, mbushur me shpresa
Dhe mora udhën pa krye nëpër udhëkryqet
Plot dredha te panjohura e te mjegullta
Ku jeta, për garniturë na ven rreziqet
Kjo jetë, një pjatë e mbushur herë me helm
a mjaltë, por më shumë ngarkuar me dyshim
pret çastin, kur ne, të shkujdesur ta hedhim
hapin se gati e ka rrjetën,si merimanga për gjahun
ne sillemi rreth sajë, brenda nëpër labirintet e
pafundme, si një sferë e hedhur nëpër shkallë,
dhe zbret duke u përplasur nëpër këmbët e sajë.
Ne jemi sfera e hedhur që bie mbi birila
Nëse i godet, i fituar do të jetë, ne se jo i humbur.
Ne, herë sferë, herë birilë, bëhemi lodër
Në lojën e egër te jetës që loz me ne
Si era me gjethet e vjeshtës.

ÇFARË PO BËJMË KËSHTU

Botën e masim me dëshpërimin tonë
Dhe themi që ka shumë e madhe,
Ndërsa njerëzit i masim me dëshirat tona
Prandaj na ngjajnë shumë të vegjël.
Kohës ia vejmë kapistallin
Pas vetes duam ta tërheqim,
Por ajo shpejt e merr vrapin
E ne mbrapa duke parë,
në mes te rrugës së dëshpërimit mbesim.
Atëherë, njëri tjetrit ja drejtojmë armën
E fajin e zëmë me gurë
Larg nga ne duke vrapuar
Te ikë, te ikë sa më shumë.
Por ai gjithnjë i afrohet lëkurës tonë
Dhe ngjitet fort shumë fort,
si krimbi mbi mishin e kalbur
e bota në duart tonë bëhet mollë
e ne kërkojmë ta gëlltisim me një kafshatë
sa i madh qenka ky oreksi ynë,
Asnjë çast nuk na len rehat?

***

Fund

Tiranë, korrik 2018

Mehmet Rrema- Valixhet e shpresave

Pasqyra e lëndës

Fq.

1.Ne ……11
2.Pyetni për mua……12
3.Do të më gjeni……..13
4.Të falem o perëndi……14
5.Meditim……15
6.Ne edhe zoti……16
7.Dëshira e një të huaji……17
8.Trenat……18
9.Lumi i vendi tim……19
10.Dhimbje për një vajzë në rrugë……20
11.Nadja……24
12.Ajo grua me shpirt kristal……29
13.Gjakmarrje……31
14.Sekrete……33
15.Ne nuk ishim asgjë……34
16.Plaku Nikollë……36
17.Shpirti i vetmuar……37
18. Pritje……38
19.Mysafir tek shqipet……39
22.A tha shpirtin ta kam vrarë……40
21.Kur linde ti……42
22. E vërteta……43
23.Shko tek lala……44
24.Njerëzit…… 45
25.Një vajze……46
26. Më jepni një emër……47
27.Fjala……48
28.Shpresa vdes në fund……49
29.Jam rritur……50
30.Lypsat……51
31.Në se do takohemi…..52
32.Unë dhe deti……53
33.Ngjashmëri……54
34.Fshatit tim…….55
35.Kënga e mërgimit……56
36.Vajzat e vendit tim……57
37.Rilindje……58
38. Qeshje…….. 59
39.Nuk e dua parajsën……61
40.Partisë së punës……62
41.Pejsazh……65

42.Tokë e djegur…..66
43.Unë vdes……67
44.Bariu……68
45.Durimi ynë……72
46.Mbuluar me vuajtjet e mija……73
47.Në mundesh……74
48.Mos e thuaj një fjalë……76
49.Po të mos ishin……77
50.Mundet……78
51.Mos dëgjo…79
52.Poeti……80
53.Kur ishim fëmijë……81
54.Kalorësi……83
55.Në galeri……85
56.Kam dëshirë sonte…86
57.Çfarë ka ndodhur në vendin tim
58.Porosi……87
59.Përshëndetje Mirditore……89
60.Zoti flet me veten……91
61.Jeto……93
62.Nuk e vret dot……94
63.Ftohtë……96
64.Los me erën……97
65.Kërkoj një tufë me lule……98
66.Nikës……99
68.Urdhër……101
69.Ali Oçalan……103
70.Letër njoftimi……120
71.Valixhet e shpresës……121
72.Çfarë po bëjmë kështu……122

***